

VENDIM
Nr.382, datë 20.6.2007

PËR DISA NDRYSHIME E SHTESA NË VENDIMIN NR.515, DATË 19.7.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR RISTRUKTURIMIN E INSTITUTEVE KËRKIMORE SHKENCORE, NË VARËSI TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12, 13 e 14, të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, të ndryshuar, të neneve 21, 27 e 29, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të neneve 22, 23 e 25, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.515, datë 19.7.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Në shtojcën 2, që i bashkëlidhet vendimit në fuqi, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Fjalja e parë, e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Trojet dhe objektet e tjera, të ndërtuara mbi to, i kalojnë Këshillit të Ministrave. Baza Eksperimentale, Selitë, zona kadastrale nr.8220, me pasuritë: 8/5; 8/6; 8/7; 8/9; 8/11; 8/13 dhe 8/16, të administrohet nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të kalojë në proces privatizimi.”.

b) Në pikën 4, të bëhen këto ndryshime:

i) Fjalja e parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Trojet dhe objektet e tjera, të ndërtuara mbi to, i kalojnë Ministrisë së Drejtësisë.”.

ii) Fjalja e pestë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Trojet dhe objektet e tjera, të ndërtuara mbi to, të Stacionit të Gjedit, zona kadastrale nr.8310, me pasuritë: 6/16; 6/462 e 6/463, të administrohen nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të kalojnë në proces privatizimi.”.

2. Pas pikës 18 shtohet pika 18/1, me këtë përmbajtje:

“18/1 Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t’i shtohet fondi prej 6 milionë lekësh, për shpenzimet e administrimit, të ruajtjes e realizimit të procesit të privatizimit të pasurisë së Bazës Eksperimentale, Selitë, dhe të Stacionit të Gjedit, si dhe për zhvendosjen e serës së fidanëve perimore, prej 370 m².

Efektet financiare të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.”.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha